

Regjistrimi i automjeteve

Regjistrimi i automjeteve në Kosovë bëhet në Qendrat për Regjistrim të Automjeteve në kuadër të ARC-së- Ministrisë së Punëve të Brendshme. Automjetet në pronësi të personave fizik regjistrohen në bazë të vendbanimit apo vendqëndrimit të pronarit. Ndërsa automjetet në pronësi të personave juridik regjistrohen në bazë të certifikatës së biznesit.

Me qëllim të ofrimit të Shërbimeve më të shpejta për qytetarët e Republikës së Kosovës, nga data 01 qershor 2015 ka hyrë në funksion sistemi on-line i aplikimit për vazhdimin e regjistrimit të automjeteve.

Për aplikim përmes sistemit on-line, fillimisht duhet t'i konfirmoni Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve një e-mail adresë tuajën.

Linku për aplikim përmes sistemit on-line është: <http://automjetetonline.rks-gov.net/>

PËR REGJISTRIMIN E AUTOMJETIT NEVOJITEN DOKUMENTET SI NË VIJIM:

Dëshmia mbi pronësinë e automjetit.

Fatura e prodhuesit – shitësit të automjetit.

Dokumenti origjinal i shtetit përkatës.

Dokumenti i identifikimit të lëshuar nga organet e Kosovës.

Polica e sigurimit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e lëshimit.

Dokumenti unik doganor, në raste të veçanta edhe vendimi doganor.

Dëshmia mbi pagesën e taksës administrative, e cila duhet të jetë e paguar brenda 30 ditësh.

Dëshmia mbi pagesën e taksës rrugore dhe ekologjike për automjetin, e cila duhet të jetë paguar brenda 30 ditësh.

Dëshmia mbi pagesën e taksës komunale.

Certifikatën e kontrollit teknik të automjetit të lëshuar nga subjekti i licencuar nga Ministria e Infrastrukturës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e lëshimit.

Automjetet e reja të cilat marrin pjesë në komunikacionin rrugor do t'i nënshtrohen kontrollit teknik gjatë muajit në të cilin i kalon afati prej 24 muajsh nga kontrolli i parë teknik.

PËR AUTOMJETET TË CILAT BARTIN MALLRA TË RREZIKSHME NEVOJITET edhe certifikata e ADR-së, e cila nuk mund të jetë më e vjetër se një (1) vit.

Të gjitha automjetet të cilat përdorin për lëndë djegëse gazin (LPG ose CNG), paraprakisht duhet të pajisen me certifikatën e atestit, pas plotësimit të kushteve të stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz, të lëshuar nga institucionet kompetente të cilat janë licencuar nga Ministria e Infrastrukturës.

NËSE JANË DISA BASHKËPRONARË TË AUTOMJETIT, automjeti regjistrohet në emër të njërit bashkëpronarë me një deklaratë me shkrim prej bashkëpronarëve të tjerë, të vërtetuar nga organi kompetent.

Kërkesën për regjistrim të automjetit e paraqet pronari i automjetit ose personi i autorizuar me autorizim të vërtetuar në gjykatë ose te noteri.

PËR AUTOMJETET E NDËRMARRJEVE PUBLIKE nevojitet autorizimi nga ndërmarrja publike.

Automjetet në pronësi të personave fizik regjistrohen në bazë të vendbanimit apo vendqëndrimit, ndërsa automjetet në pronësi të personave juridik regjistrohen në bazë të certifikatës së biznesit.

PËR REGJISTRIMIN E AUTOMJETIT PËR HERË TË PARË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS nevojitet edhe certifikata e homologimit.

PËR MJETIN E PUNËS - TRAKTOR, për të cilët pala nuk posedon dokument, të cilët kanë ekzistuar në Kosovë para 10 qershorit 1999, pala mund ta regjistrojë traktorin me deklaratën e dy dëshmitarëve të vërtetuar në gjykatë ose nga noteri.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR VAZHDIMIN E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT ËSHTË:

Certifikata e regjistrimit të automjetit, CRA.

Certifikata e rregullsisë teknike e automjetit.

Polica e sigurimit dhe dëshmia e pagesës në bankë, ndërsa për institucionet shtetërore dhe kompanitë publike nevojitet vetëm marrëveshja në mes të kompanisë dhe institucioneve (profaktura e sigurimit).

Prezantimi i dokumentit të identifikimit të pronarit.

Dëshmia mbi pagesat e taksave.

Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit mund të bëhet maksimalisht pesëmbëdhjetë (15) ditë para kalimit të afatit të regjistrimit të mëparshëm.

Qendra e Regjistrimit të Automjeteve është e obliguar të bëjë vazhdimin e regjistrimit të automjetit nga data e skadimit të afatit të regjistrimit.

Pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditë nga data e skadimit të regjistrimit të automjetit, pronari i automjetit është i detyruar të paguaj taksën administrative për çdo tridhjetë (30) ditë, ashtu siç është përcaktuar në vendimin për tarifa.

Ç'REGJISTRIMI I AUTOMJETIT

Për ç 'regjistrim të automjetit nevojitet:

Kërkesa për ç 'regjistrim të automjetit.

Dorëzimi i targave të regjistrimit në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve.

Prezantimi i certifikatës së regjistrimit të automjetit, CRA-së.

Certifikata e regjistrimit të automjeteve, e ç 'lajmëruar, në origjinal i kthehet palës, ku evidentohet data e ç 'regjistrimit.

Pala ka të drejtë të bëjë ç ' regjistrimin brenda 30 ditëve pas skadimit të afatit të vazhdimin. Ç ' regjistrimi i automjetit bëhet në bazën e të dhënave.

Në rast të vdekjes së pronarit të automjetit, familja e ngushtë mund ta bëjë ç ' regjistrimin e automjetit me dëshminë e certifikatës së vdekjes.

Ç'REGJISTRIMI I AUTOMJETIT BËHET NË KËTO RASTE:

- Në rastin e mos vazhdimin të regjistrimit, amortizimit, dëmtimit, aksidentit dhe daljes së automjetit jashtë funksionit për çfarëdo arsye, bëhet ç ' regjistrimi dhe kthimi i targave me kërkesën e palës.

Nëse automjeti është vjedhur, duhet të sjellë raportin e policisë si dëshmi për ç' regjistrim.

Pas skadimit të vlefshmërisë së regjistrimit brenda afatit 30 ditë, nëse këto automjete nuk regjistrohen ose nuk ç' regjistrohen, atëherë do të kalojnë në automjete pasive në bazën e të dhënave mbi regjistrimin e automjeteve.

Pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditësh pronari i automjetit është i detyruar të paguaj taksën administrative për çdo tridhjetë (30) ditë, sipas vendimit mbi tarifatat Nr.210/2015.

HUMBJA APO VJEDHJA E TARGAVE APO CERTIFIKATËS SE REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT

Në rastin e humbjes apo vjedhjes së certifikatës së regjistrimit të automjetit ose targave të regjistrimit, pronari apo përdoruesi i automjetit duhet të lajmëroj në stacionin më të afërt policor. Policia pas lajmërimit të rastit, duhet ta lëshoj dokumentin për humbjen apo vjedhjen e certifikatës së regjistrimit të automjetit ose targave, sipas pohimit të lajmëruesit.

Ky dokument duhet t'i përmbaj të dhënat e mjaftueshme për pronarin, automjetin, certifikata e regjistrimit të automjetit ose targat.

Në rastin e dëmtimit të certifikatës së regjistrimit të automjetit ose targave, pala duhet që këto (Certifikata ose targat e dëmtuara), t'ia dorëzoj Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve dhe më pas ai e merr certifikatën e regjistrimit të automjetit të re ose targat e reja të cilat i paguan sipas vendimit mbi tarifatat.

Për ndërrim të certifikatës së regjistrimit të automjetit ose targave bëhet kërkesa me shkrim.

RI REGJISTRIMI I AUTOMJETIT

Në rastin kur automjeti është i ç' lajmëruar dhe kërkohet nga pala të bëhet ri regjistrimi, nevojiten këto dokumente:

Certifikata e regjistrimit të automjetit, e ç' lajmëruar; (CRA e ç' regjistruar).

Certifikata e kontrollës teknike.

Polica e sigurimit dhe dëshmia mbi pagesën.

Pagesa e taksave administrative sipas vendimit mbi tarifat Nr.210/2015.

Në rast të ndërrimit të pronarit kërkohet kontrata e shitblerjes, kontrata mbi dhuratën, akti i trashëgimisë, dokumenti me anën e të cilit është fituar pronësia.

Automjetet që shiten në ankand publik të cilat më parë janë konfiskuar nga organet kompetente, mund të ri regjistrohen me vendim ekzekutiv të gjykatës, vendimin e organeve të ndjekjes, si dhe aktin e shitblerjes të Shërbimit Doganor të Kosovës.

Për automjetet që më parë janë ç' lajmëruar dhe duhet të bëhet bartja e pronësisë, edhe nëse blerësi i takon një komunë tjetër, mund të ri regjistrohet në QRA (Qendra e Regjistrimit të Automjeteve) në bazë të vendbanimit ose vendqëndrimit të qytetarit.

Automjetet e ç' lajmëruara mund ta bëjnë ri regjistrimin duke përfshirë taksat për ri regjistrim.

Legalizimi i Automjeteve

Automjetet të cilat për një arsye apo tjetër janë regjistruar në mënyrë jo të rregullt i nënshtrohen procesit të legalizimit, pas përfundimit të procedurave administrative dhe ligjore.

TRANSFERIMI I LËNDËVE

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase, qytetarëve iu mundësohet transferimi i lëndëve sipas vendbanimit.

Me rastin e transferimit të lëndëve pala është e obliguar t'i kthej targat e automjetit në QRA-në ku i ka marrë targat e fundit, me përjashtim kur transferimi i lëndës bëhet në kuadër të rajonit të njëjtë.

Me rastin e shitblerjes apo ç' regjistrimit të automjetit, pronari i automjetit ka të drejtë t'i mbajë targat edhe pas shitjes së automjetit, në afatin brenda (60) ditësh, përjashtimisht, rasteve për targat zyrtare të institucioneve shtetërore.

Nëse pala në automjetin e ri të cilin do ta regjistroj dëshiron t'i mbajë targat e njëjta (të ruajtura), lirohet nga taksa administrative për targa.

TARGAT PROVUESE

Lëshimi i targave provuese nuk nënkupton regjistrim të automjetit. Por, dhënia e targave provuese është mundësi për kyçje në komunikacionin rrugorë për kohën e përcaktuar.

Targat provuese mund të lëshohen për automjete motorike dhe bashkëngjitëse. Me rastin e dhënies së targave provuese, palës i lëshohet një vërtetim nga DRA.

Targat provuese jepen nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve sipas kërkesës së pronarit të automjetit, në këto raste:

Për automjete të reja.

Për automjete të përdorura dhe të riparuar me të cilat kryhet vozitja provuese për testimin e automjetit dhe gjendjes së tij.

Automjetet që lëvizin nga selia e ndërmarrjes prodhuese deri në selinë e ndërmarrjes që i shet.

Për automjetet që lëvizin në panaire, auto sallone për qëllim të shitjes.

Automjetet që lëvizin për t'i dërguar në kontrollim teknik të cilave iu ka skaduar regjistrimi.

Për lëshimin e targave provuese kërkohen këto dokumente:

Dëshmia mbi pronësinë.

Kërkesa për lejimin e targave provuese.

Dëshmia mbi pagesën e taksave administrative.

Pagesa e targave provuese.

Dëshmia mbi pagesën e sigurimit ndaj palëve të treta.

Targat provuese lëshohen me afat deri në 15 ditë.

Targat provuese mund të lëshohen sipas kërkesës së palës në QRA (Qendra e Regjistrimit të Automjeteve) më të afërt me pikën kufitare të hyrjes së mjetit motorik.

Përrjashtimisht paragrafit 5 t këtij neni, Ministri me një vendim mund t'i përcaktoj targat provuese edhe me një afat më të gjatë kohor.

Në raste të veçanta targat provuese mund t'i lëshoj edhe Policia Kufitare.

NDËRRIMI I PRONARIT TË AUTOMJETIT

Në rast të ndërrimit të pronarit, pronarit të ri i kërkohen këto dokumente:

Kërkesa për ndërrim pronari.

Kontrata e shitblerjes apo dokument tjetër të vërtetuar nga gjykata ose nga noteri që dëshmon mbi fitimin e pronësisë në pajtim me ligjin, apo me rastin e vdekjes së pronarit të automjetit aktin noterial mbi kalimin e pronësisë.

Certifikata e regjistrimit të automjetit, e pronarit paraprak.

Polica e sigurimit në emër të pronarit të ri me dëshmi për pagesën e kryer.

Certifikatën mbi konfirmimin e rregullsisë teknike në emër të pronarit të ri, nëse automjeti nuk ka vazhdim.

Dokumentin e identifikimit personal të shitësit dhe blerësit, kurse në rastin kur kontrata e shitblerjes vërtetohet nga gjykata ose noteri, dokumentet e identifikimit nuk janë të domosdoshme.

Për institucionet shtetërore nevojitet dëshmia mbi transferin e automjetit.

REGJISTRIMI I PËRKOHESHËM

Regjistrimin e përkohshëm mund ta bëjnë shtetasit e huaj të cilët përkohësisht qëndrojnë në territorin e Republikës së Kosovës, studentët që vijojnë mësimet, specializimet, hulumtimet shkencore dhe punëtorët e huaj që janë në marrëdhënie të përkohshme pune në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit.

Targat e përkohshme nuk mund të jepen në afat më të shkurtër se dy (2) muaj e as në afat më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

Regjistrimi i përkohshëm bëhet për: mjetet motorike të cilat në bazë të kontratës mbi bashkëpunimin ekonomik shfrytëzohen në mes të kompanive transportuese vendore dhe të huaja.

Mjetet motorike të përfaqësive të huaja të cilat përkohësisht ushtrojnë veprimtari afariste në territorin e Republikës së Kosovës.

Vazhdimi i regjistrimit të përkohshëm mund të bëhet në rast se dogana e vazhdon lirim nga dogana.

Për regjistrimin e përkohshëm kërkohen këto dokumente:

Dokumenti Unik Doganor (DUD), në raste të veçanta vendimi doganor ku do të precizohet e drejta mbi importin e përkohshëm.

Dokumenti i qëndrimit për të huaj i lëshuar nga organet kompetente të Republikës së Kosovës.

Dëshmia mbi pronësinë e automjetit.

Fatura e prodhuesit – shitësit të automjetit.

Dokumenti original i shtetit përkatës.

Dokumenti i identifikimit të lëshuar nga organet e Kosovës.

Polica e sigurimit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e lëshimit.

Dëshmia mbi pagesën e taksës.

Dëshmia mbi pagesën e taksës rrugore dhe ekologjike për automjetin.

Certifikatën e kontrollit teknik të automjetit të lëshuar nga subjekti i licencuar nga organi kompetent, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e lëshimit.

Automjetet e reja të cilat marrin pjesë në komunikacionin rrugor do t'i nënshtrohen kontrollit teknik gjatë muajit në të cilin i kalon afati prej 24 muajsh nga kontrolli i parë teknik.

Pas kalimit të afatit të regjistrimit të përkohshëm të automjetit, me kërkesën e palës QRA është e obliguar t'ia kthej librezën e origjinës.

TARGAT ME POROSI

Pronari i automjetit me rastin e regjistrimit të automjetit, ka të drejtë të bëjë porosi për targa me numrat dhe shkronjat e dëshiruara.

Numrat e zgjedhur janë tre shifror, duke filluar nga numrat 101 deri në 999 dhe kombinimi i mundshëm i shkronjave.

Taksat për targa me porosi janë përcaktuar me vendimin mbi tarifën.

XHAMAT E HIJEZUAR

Xhamat e hijezuar mund t'i gëzojnë të gjithë qytetarët vetëm për ato automjete të cilat si të tilla janë të prodhuara nga vetë prodhuesi i mjetit motorik.

Evidentimi i posedimit të xhamave të hijezuar pas konstatimit të gjendjes teknike shënohet në CRA (Certifikata e Regjistrimit të Automjeteve) në rubrikën “ shënime”.

Vendosja e letrës së errët ngjitëse për hijezim në xhamat e automjeteve është e ndaluar, përveç rasteve kur përcaktohet me vendim të Ministrit të MPB-së.

Për vazhdimin e regjistrimit të automjetit, përdoret edhe sistemi on-line në këtë web faqe:

LLOJET E TARGAVE NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

1. Targa të rëndomta.
2. Targa provuese.
3. Targa të përkohshme.
4. Targa të Institucioneve (Presidenca, Kuvendi, Qeveria).
5. Targa të FSK.
6. Targa të Policisë.
7. Targa të e Doganës së Kosovës.
8. Targa për shërbime emergjente.
9. Targa komunale.
10. Targa për makina bujqësore.
11. Targa për motoçikleta.
12. Targa -CD-diplomatike.
13. Targa për Institucionet e Drejtësisë.
14. Targat e Agjencive të pavarura.
15. Targat me porosi.

Për të gjitha llojet e rimorkiove dhe për motoçikleta, jepet vetëm një targë dhe CRA-ja.